

VENDIM
Nr. 194, datë 31.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020,
“PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT,
FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Shkronja “ë”, e pikës 4, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“ë) vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i shtimit të vendeve të lira të punës në aktivitetin e punëdhënësit.”;
- b) Në fund të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “dh”, të pikës 2, të kreut III, shtohen fjalët “... të kompensuar çdo muaj.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe